RAPORT PER AUDITIMIN E FONDEVE TË SHPENZUARA NGA FEDERATA SHQIPTARE E GJIMNASTIKES PER AKTIVITETET E FINANCUARA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË, 11.02.2026

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për bordin drejtues te Federates Shqiptare te Gjimnastikes

Unë, Admir Kajo, Auditues ligjor, me licence profesionale nr. 369 date 15.02.2019 dhe NIPT K71717029E, ne baze te Kontratës së Shërbimit datë 05/02/2026, të lidhur me subjektin Federata Shqiptare e Gjimnastikes, me qëllim Auditimin e fondeve të shpenzuara në kuadër të granteve te dhena nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për mbështetje financiare në fushën e sportit te gjimnastikës, paraqes raportin e auditimit per dhenien dhe perdorimin e ketyre fondeve per vitin 2025.

Opinion

Sipas opinionit tim, duke u bazuar në kërkesat ligjore, gjykoj se Federata Shqiptare e gjimnastikës *, ka zbatuar drejt kerkesat për përdorimin e fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit në përputhje me buxhetin e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për mbështetje financiare të granteve në fushën e sportit.*

Baza për opinion

Unë si ekspert, jam i pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e këtij projekti në përputhje me Kodin e Etikës për EKR-të, dhe kam përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Unë besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Kam marrë në shqyrtim të gjitha raportet financiare të përgatitura nga menaxhmenti i federates, buxhetin e miratuar nga Financuesi dhe dokumentacionin që justifikon këto transaksione dhe shpenzime. Kam shqyrtuar diferencat mes buxhetit dhe shpenzimeve faktike dhe kam patur shpjegime nga menaxhmenti lidhur me devijimet.

Kam verifikuar me zgjedhje dokumentacionin që justifikon shpenzimet faktike të raportuara, si faturat, kontratat, mandat pagesat e bankës, deklarimet tatimore nga të cilat janë kryer pagesat.

Unë besoj se evidenca e marrë për auditimin e projektit përmban dokumentacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbështetës për opinionin tim.



Theksimi i çështjes - Baza e kontabilitetit dhe kufizimi në shpërndarje

Pa modifikuar opinionin tim, tërheq vëmendjen për faktin se Federata Shqiptare e Gjimnastikës *është audituar vetëm për shpenzimet e kryera në kuadër të granteve te dhena nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit Kultures dhe Sportit. Si rezultat, ky raport auditi mund të mos jetë i përshtatshme për qëllime të tjera. Raporti i drejtohet menaxhmentit të Federates Shqiptare te* Gjimnastikës, *Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrise se Turizmit, Kultures dhe Sportit dhe nuk duhet t'i shpërndahet ose përdoret nga palë të treta.*
Unë kam audituar vetëm raportin financiar për te ardhurat dhe shpenzimet e permenduara me lart dhe nuk kam audituar pasqyrat financiare të përgjithshme të Federates Shqiptare te Gjimnastikës, *për rrjedhojë nuk shpreh opinion mbi aktivet, detyrimet dhe aktivet neto të saj.*

Tirane me 11.02.2026

Auditues ligjor
Admir KAJO



Adresa:
Rr. "Hamid Shijaku", Pallati Nr.41/2,
Ap.2, Zyra Nr.1, Tirane
Mob 0692175263
Lic. prof. Nr 369; NIPT K71717029E

SHËNIME MBI RAPORTIN FINANCIAR TË PASQYRES SE TE ARDHURA-SHPENZIME PER GRANTET E DHENA GJATE VITIT 2025 NGA MAS

1. Natyra e aktiviteteve dhe politikat kontabël të rëndësishme

(a) Natyra e Aktiviteteve

Federata Shqiptare e Gjimnastikes, është një organizatë jofitimprurëse në formën e Qendrës, regjistruar si person juridik në regjistrin e OJF-ve me vendimin Nr. 2638, datë 28.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K51714001B me seli në adresën; Rruga "Liman Kaba"Parku Olimpik" Tiranë, përfaqësuar nga Sekretarja e Pergjithshme Znj. Eliriana Karaj.

Grantet e marra nga ana e Federates jane shpenzuar ne funksion te zhvillimit dhe promovimit te Sportit te gjimnastikes, nepermjet organizimit te aktiviteteve dhe pjesemarrjen ne aktivitete nderkombetare.

Objektivat kryesore të Federates janë:

- Te zhvilloje, promovoje, kontrolloje dhe rregulloje aktivitetin sportive ne sportin e gjimnastikes e te gjitha disiplinave,grup-moshave , gjinive etj.
- Te ndihmoje ne rritjen dhe zhvillimin e marredhenieve profesionale dhe miqesore midis anetareve te FSHGJ dhe te mbroje te drejtat e anetareve te saj.
- Te marre masa per ndalimin e diskriminimit ne veprimtarite sportive per shkaqe si bindjet poliike e fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqerore.
- Te organizoje Kampionatin Kombetar dhe Kupen e Republikes, dhe te shpalle Kampionin Kombetare dhe Ekipin Kampion Kombetar ne sportin e gjimnastikes dhe disiplinat perkatese.
- Te koordinoje dhe jape pelqimin per kryerjen e veprimtarive dhe garave sportive te anetareve te saj.
- Te organizoje ne Republiken e Shqiperise veprimtari sportive nderkombetare ose te autorizoje pjesemarrjen e anetareve te saj ne keto veprimtari.
- Te mbeshtese promovimin e sportisteve dhe parasportisteve ne planin social, gjate dhe pas karrieres se tyre sportive.
-

(b) Politikat Kontabël

Raporti Financiar i mësipërm i Fondit Grant është përgatitur nga menaxhmenti i Federates Shqiptare te Gjimnastikes me qëllim përmbushjen e një kërkese të vendosur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit, Kultures dhe Sportit. Zërat paraqiten në përputhje me bazën e kontabilitetit të arkëtimeve dhe pagesave të modifikuar, ku të ardhurat njihen kur ato janë të disponueshme për përdorim dhe shpenzimet njihen kur paguhen ose kur efektet financiare janë realizuar ose kanë ndodhur.

TIRANA - ALBANIA addvise AUDIT & ACCOUNTING NIPT: K71717029E

(c) Monedha raportuese
Regjistrimet kontabël të Fondeve grant mbahen në lekë, që është monedha funksionale dhe raportuese, ndërsa fondet kanë ardhur në lekë dhe shpenzimet janë bërë kryesisht në lekë por dhe në monedhën euro.

2. Të ardhurat

Të ardhurat janë paraqitur mbi bazën e kontabilitetit të arkëtimeve dhe pagesave të modifikuar dhe janë njohur kur ato janë bërë të disponueshme për përdorim. Në datën e raportimit, në mbyllje të vitit fiskal, duhet të bëhen disa modifikime të caktuara për të përgatitur bilancin e organizatës.

Aktiviteti vjetor kryesor eshte financuar fillimisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit .

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka financuar me grante ne shumen 4,700,000 leke, sipas shkreses nr.1239/3 prot date 26.02.2025 , nepermjet buxhetit te shtetit ne llogarine e thesarit ne llogarine ekonomike 604 (transferta te brendshme).

Gjithsej te ardhurat nga grantet/financimet jane ne shumen 4,700,000 leke.

3. Shpenzimet e kryera

Shpenzimet njihen kur paguhen ose kur efektet financiare janë realizuar ose kanë ndodhur. Te permbledhura paraqiten si me poshte:

- Financimi i kontratave të punësimit 2025 dhe detyrime te 2024	1,767,052 leke
- Shpenzime operative të aktiviteteve ndërkombëtare	2,251,715 leke
- Shpenzime operative të aktiviteteve kombëtare	317,750 leke
- Shpenzime te ndryshme operative	363,483 leke
Totali I shpenzimeve	**4,700,000 leke**

Rezultat

Vlera e pashpenzuar nga buxheti i miratuar prej 4,700,000 lekë i Ministrive së Arsimit dhe Sportit eshte ne shumen 0 (zero) leke.

Tirane me 11.02.2026

Auditues ligjor
Admir KAJO

TIRANA - ALBANIA
addvise
AUDIT & ACCOUNTING
NIPT: K71717029E

Letër Menaxhmenti

Prezantimi

Ne kemi audituar raportin financiar të Fondeve Grant të zbatuar nga Federata Shqiptare e Gjimnastikes, i cili përfshin Raportin Financiar për shumën e shpenzimit prej 4,700,000 lekë (katermilion e shtateqindmije).

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin te profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontablit te Miratuar" si dhe ligjit Ligj 25/2018 Date 10.05.2018, Per Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare. Ai përfshin teste dhe kontrolle sipas nevojës për të përmbushur objektivat e auditimit.

Kërkesat tona të auditimit iu prezantuan Menaxhmentit të Organizatës duke përfshirë informacionin e kontabilitetit dhe auditimit në formë elektronike. Informacioni është marrë dhe përpunuar për të marrë njohuritë e nevojshme për Projektin; për të vlerësuar rreziqet e përfshira dhe; për të përgatitur planin e auditimit.

Një takim u mbajt midis përfaqësuesve të Organizatës dhe ekipit të auditimit ku u diskutuan objektivat e auditimit. Informacioni i marrë është përdorur për të rishikuar procedurat e auditimit sipas nevojës. Gjatë punës në terren fokusi i procedurave tona të auditimit ishte të sigurohej nëse:

- Të dhënat janë mbajtur si duhet dhe informacioni kontabël ishte i përshtatshëm.
- Organizata kishte ndjekur rregulloret e Financuesit.
- Kostot e raportuara ishin për projektin dhe të mbështetura me dokumentacionin e duhur.
- Raporti financiar është në përputhje me buxhetin e miratuar.

Ne kemi vëzhguar 100% të shpenzimeve të raportuara.

Gjatë auditimit ne nuk kemi pasur dijeni për ndonjë çështje që ndikon në forcimin e kontrollit të brendshëm dhe/ose rritjen e mundshme të efikasitetit. Kjo Letër Menaxhmenti nuk ndikon në raportin tonë mbi raportin financiar të "Federates Shqiptare te Gjimnastikes" për fondin Grant 2025.

Kjo letër ka për qëllim vetëm informimin dhe përdorimin e menaxhmentit të "Federates Shqiptare te Gjimnastikes" dhe Ministrive qe kane financuar Grantin ajo e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit, Kultures dhe Sportit.

Firma dhe Vula

TIRANA - ALBANIA addvise AUDIT & ACCOUNTING NIPT: K71717025E

11.02.2026

Date